# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-477333**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Intervista në Syri TV - VIDEO/ Bajaziti: Rama e ka shndërruar komunikimin publik në qesharak, kërkon nga Europa të mos e lërë në baltë |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/919791/video-bajaziti-rama-e-ka-shnderruar-komunikimin-publik-ne-qesharak-kerkon-nga-europa-te-mos-e-lere-ne-balte/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 18:19:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 18:12:25 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b2006be9d39c63b8e8d5e2675f86cffc4539c36b3626c55e26e58c59e09ae94a` |
| TEKSTI | `dddda1e3f6f1f47aa47fef2e55c5c9d01cf83f82581afce4bed11608b5eb8c4a` |
| PAMJA | `08871a9bfe69f9d21fa90657f2b0704881381be88367e0937b654e9f124708b0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `689e7bd0ffef93cd8957760e37a822badb65c92a5223c532d584da1bbdce9271` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/689e7bd0ffef93cd8957760e37a822badb65c92a5223c532d584da1bbdce9271`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEKA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

LAJMI I FUNDIT

LIVE - 'Nuk ka kthim pas!'/ 121 ditë protesta, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Edi Ramës

# VIDEO/ Bajaziti: Rama e ka shndërruar komunikimin publik në qesharak, kërkon nga Europa të mos e lërë në baltë

20:12, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ Aa -

Nënkryetarja e Partisë Demokratike, Erisa Bajaziti, e ftuar në emisionin 'Ora 19' në SYRI TV me moderatoren Armela Ferko, ka komentuar komunikimin publik të kryeministrit Edi Rama dhe fjalën e tij në një prej eventeve të zhvilluara gjatë ditës së sotme.

Bajaziti e cilësoi shqetësues mënyrën se si kryeministri po komunikon me publikun, duke thënë se Rama i ka zëvendësuar konferencat për shtyp me video-mesazhe.

Duke iu referuar deklaratave të kryeministrit në eventin e sotëm, Bajaziti tha se Rama e nisi fjalën e tij me atë që ajo e konsideron si 'paranojë', duke përmendur edhe zgjedhjen për të folur në anglisht.

Sipas saj, Rama shprehu frikën për përkthyesin dhe zgjodhi të fliste në anglisht, duke anashkaluar, sipas saj, publikun shqiptar që kërkon ta dëgjojë kryeministrin të flasë edhe në gjuhën shqipe.

Më tej, nënkryetarja e PD-së e krahasoi këtë qasje me atë të një 'lypësi në dyert e Europës', duke argumentuar se kryeministri duhet të fokusohet te forcimi i institucioneve shqiptare dhe zbatimi i reformave.

*'Në fakt është shumë shqetësuese sa herë e sheh kryeministrin të dalë në një video-mesazh, sepse ai me sa duket edhe në fakt mesazhin dhe komunikimin publik e ka shndërruar në diçka qesharake, sepse video-mesazhet, pra konferencat për shtyp i ka zëvendësuar me video-mesazhe.*

*Po, tek deklaratat. Dhe dua të dal tek mungesa e përmbajtjes së kryeministrit kur del në deklarata të tilla apo shfaqet në evente të rëndësishme si kjo e sotmja.*

*Në fakt kryeministri shqiptar e nisi fjalën e tij me paranojën që e mbizotëron tashmë tek figura e tij si kryeministër, duke e nisur fillimisht me frikën që kishte*

## më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s'menaxhon dot më

'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?

Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?

Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuan se orteku i opozitës po rritet çdo ditë

*nga përkthyesi dhe preferoi që të fliste në anglisht, duke anashkaluar një publik shqiptar që kërkon ta dëgjojë kryeministrin të flasë edhe shqip. Ai gjithashtu u kërkoi aktorëve ndërkombëtarë në atë event që të mos e linin në baltë. Pra, i kërkon Bashkimit Europian të mos e lërë në baltë.*

*Dhe duket sikur kryeministri shqiptar është një lypës në dyert e Europës, e jo si një aktor që është duke punuar për të forcuar institucionet shqiptare. Sepse kjo është një kërkesë e qartë që vjen nga Bashkimi Europian.*

*Është një gjë të bësh ligje të mira dhe është diçka tjetër të zbatosh ligjet dhe reformat, sepse kjo do të ndihet direkt në jetën e qytetarëve shqiptarë. Dhe kryeministri shqiptar, përpara se të bëjë parodi, le të flasë për cilësinë e institucioneve dhe për skandalet në të cilat po kalon sot Shqipëria, përpara se t'i flasi zyrtarëve të lartë, pra parlamentarëve që kanë qenë sot të pranishëm në atë event, për gangsterë rusë dhe lodra kineze.'*, u shpreh Erisa Bajaziti në SYRI TV.

© SYRI.net

Lexo edhe:


FOTO/ Pankartat: Këshilli i Sigurisë, shumë karrige, shumë fjalë, po përgjegjësia ku ka për të dalë?


Takimi i Spiropalit me raporterin europian/ Kafe informale apo 'mesazh' për Ramën?


Dita e 121-të e protestës, nis marshimi i qytetarëve drejt Kryeministrisë: Rama, jepe dorëheqjen!

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

TË NGJASHME

VIDEO-'Ora 400 mijë euro dhe skandali i SHISH'/ Çollaku: Edi Rama e di çfarë do të dalë nga dosjet

'Rama varrosi për së gjalli Belerin'/ Burimi: Rama dosjen e Berishës e çoi në media. Kërcënoi BE me rusët e kinezët

Berisha me kongresmenë e zyrtarë të lartë amerikanë, Rama me Ballën/ PD: Fotot flasin vetë!

'Nuk ka kthim pas!'/ 121 ditë protesta, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Edi Ramës

Belshi refuzon shkrirjen me Elbasanin, PD voton kundër, PS abstenon në Këshill

'Gjithçka pjesë e një skeme me bekimin e Ramës', Boçi: Informacioni është pushtet

Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga 'republika e prokurorëve', por nga republika e të korruptuarve



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.